

1804

4514



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Tiranë, më 02.06.2021

Lënda: Kthim përgjigjeje

Drejtuar: Qendrës "Res Publica"

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion mbi masat administrative të vendosura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në bazë të pikës 2 të nenit 3 të aktit normativ nr. 3, datë 15.03.2020, për periudhën 25 Shkurt 2021 deri më datë 20 Prill 2021, Ju bëjmë me dije si vijon:

Sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19", i ndryshuar, neni 2 përcakton se: "Subjektet apo individët që organizojnë zhvillimin e aktiviteteve publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca apo grumbullime masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milion) lekë për organizatorët dhe ndalimin e aktivitetit".

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, Policia e Shtetit, gjatë periudhës 25 Shkurt 2021- 20 Prill 2021, ka konstatuar dhe ndëshkuar administrativisht, 7 përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike, konkretisht 2 në Tiranë, 1 në Berat, 3 në Korçë dhe 1 në Dibër.

Për çdo masë administrative është dhënë njoftim nga strukturat e Policisë së Shtetit në qarqet përkatëse.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Koordinatori për të Drejtën për Informim

Gentian Mullaj